**VENDIM**
**I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE AKSIONAREVE TE SHOQERISE**
**"QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" SH.A.**
**Datë 23.12.2019**

Sot, me date 23 Dhjetor 2019, ne seline e shoqerise "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" SH.A., u zhvillua mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te shoqerise me rend dite si me poshte vijon:

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit te Auditit Ligjor per rritjen e Kapitalit themeltar te Shoqerise, bazuar ne Vendimet e Keshillit te Ministrave.

2. Te ndryshme, te lidhura kryesisht me rregullimet kontabel te kerkuara, dhe me caktimin e Auditorit Ligjor per rritjen e kapitalit, me vleren e investuar per ndertimin e stadiumit te ri.

Ne lidhje me piken e pare te rendit te dites, bazuar ne Vendimin e Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" Sh.a, date 08 Maj 2019,": Per zmadhimin ne natyre te kapitalit themeltar te shoqerise'', dhe bazuar ne VKM me Nr.79, date 02.02.2011, VKM me Nr.715, date 16.10.2012, VKM me Nr.582, date 03.08.2016, VKM me Nr. 728, date 08.12.2017, statutin e shoqerise "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" SH.A, ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare ne RSH",

**Asambleja e Pergjithshme e Aksionareve pas shqyrtimit te rendit te dites, dhe leximit te raportit te zmadhimit ne natyre te kapitalit themelimit dhe te verifikimit te praktikes dokumentare, per zmadhim te kapitalit themeltar,**

**VENDOSI :**

1. Te miratoj raportin e auditit ligjor, per zmadhimin e kapitalit te themelimit te shoqerise "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" SH.A, Tirane, ne vleren 6,412,997,540 Lek.

2. Kapitali i themelimit, para zmadhimit ishte 2 000 000 (dy milion) lek, dhe pas zmadhimit te kapitalit themeltar nga kontributet ne natyre edhe per vleren 6,410,997,540 Lek, behet 6,412,997,540 Lek (gjashte miliard e katerqindedymbedhjete milion e nenteqindenentedhjeteeshtate mije e peseqindedyzet) Lek, pra Vlera totale kapitali themeltar pas zmadhimit eshte ne vleren 6,412,997,540 Lek.

3. Numri i aksioneve, nga 2,000 (dymije) aksione para zmadhimit, pas zmadhimit te kapitalit themeltar behet 6,412,997.54 (gjashte milion e katerqindedymbedhjete mije e nenteqindenentedhjeteeshtate pike pesedhjeteekater) aksione,

4. Vlera nominale nje aksioni ishte 1 000 (njemije) Lek/nje aksion dhe mbetet e pa ndryshuar ne vleren 1 000 (njemije) Lek/nje aksion.

5. Nuk ka ndryshime ne perqindjet e zoterimeve te aksioneve te kapitalit aksionar te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane, pra, pas zmadhimit te kapitalit perqindjet e zoterimeve mbi aksionet e kapitalit themeltar, jane perkatesisht :

- Federata Shqiptare e Futbollit, zoteron 75 %, te totalit te vleres se aksioneve, baras me nje vlere 4,809,748,155 Lek.
- Ministria e Financave dhe Ekonomise (ka qene: Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes), zoteron 25%, te totalit te vleres se aksioneve, baras me nje vlere 1,603,249,385 Lek.

- Drejtimi i shoqerise te beje depozitimin e praktikes prane QKB, Tirane, artikulimet perkatese kontabile dhe reflektimin e tyre ne pasqyrat financiare te vitit 2019.

Ne lidhje me piken e dyte te rendit te dites, pasi shqyrtoj referimin e bere nga Administratori i Shoqerise ne lidhje me investimin e bere per ndertimin e stadiumit, i cili eshte duke u finalizuar, dhe nevojen per te kapitalizuar si kapital te ketyre investimeve, vendosi:

1. Te aprovoj ne parim nevojen per kapitalizimin e ketyre investimeve si kapital i shoqerise, duke mos ndryshuar perqindjet e zoterimeve te aksioneve.
2. Te caktoj z. Kristaq Ndini, Auditues Ligjor per pergatitjen e raportit te zmadhimit te kapitalit aksionar me vleren e investimit, ku te analizohen raportet dhe kontributet perkatese te aksionareve. Ky raport duhet te jete gati per diskutim dhe aprovim per mbledhjen e ardhshme te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve.
3. Te caktoj z. Kristaq Ndini, Auditues Ligjor per pergatitjen e raportit te zvogelimit te kapitalit aksionar, me humbjet e akumuluara qe kane rezultuar nga zhvleresimi i aktiveve te stadiumit ekzistues.

**Per Asamblene e Pergjithshme te Aksionareve**
**ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

| | |
|---|---|
| **FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT** | **Ministria e Financave dhe Ekonomisë.** |
| Përfaqësuar nga<br>**z. Armand DUKA** | (në mungesë) |

QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI SH.A. TIRANE - ALBANIA

**Shoqëria "QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI" sh.a**

Tiranë, Rruga "Elbasanit",
NUIS: L 11705012 O

Nr 10 Prot

Tirane, më 02.12.2019

**Drejtuar:** Federatës Shqiptare të Futbollit
z. Armand Duka

Ministrise se Financave dhe Ekonomisë
znj.Anila Denaj

**Lënda:** Njoftim per mbledhjen e Asamblesë se Aksionereve të Shoqërisë " Qendra Sportive Kuq e Zi" Sh.a

Te nderuar zotërinj.

Në mbështetje te Nenit 17 te Statutit te Shoqërisë dhe neneve 136, 137, 138 dhe 139 te Ligjit Nr,9901,date 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" ju njoftojmë për mbledhje te Asamblesë se Aksionereve te Shoqërisë "Qendra Sportive Kuq e Zi" Sh.a, ne datën 23.12.2019 10:00, pranë ambienteve të Federatës Shqiptare te Futbollit.

Rendi i ditës se mbledhjes do te jete si me poshtë:

1. Miratimi i Raportit te Auditit Ligjor per rritjen e Kapitalit themeltar te Shoqerise, bazuar ne Vendimet e Keshillit te Ministrave.
2. Te ndryshme;

Me respekt,

**Bardhyl Minxhozi**
**Administrator**

QENDRA SPORTIVE KUQ E ZI SH.A. TIRANE - ALBANIA

## RAPORT

I AUDITIT LIGJOR PER ZMADHIMIN NE NATYRE TE KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE
"Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane.

**Drejtuar :**

**- Aksionareve te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane.**

**- Zt. Bardhyl Minxhozi, administrator i shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane.**

**Te nderuar Z. Aksionar,**
**I nderuar Z. Minxhozi.**

Kam nderin, qe sa me poshte vijon, t'Ju paraqes raportin e Audit Ligjor, lidhur me zmadhimin ne natyre te kapitalit te themlimit te shoqerise, "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane.

Une Kristaq Ndini , Audit Ligjor, me License E.K.R, Nr.88, date, 10.01.2001 dhe License Tatimore, me NIUS, L 51418035 U, me Vendimin e dates 08 Maj 2019, te asamblese se pergjithshme te aksionareve te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane, jam caktuar, qe me cilesine e Auditit Ligjor, te kryhej ekspertizen kontabile per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise nga kontributet ne natyre te aksionareve te shoqerise.
Ekspertiza per zmadhimin e kapitalit themeltar behet per te dhene nga une, me cilesine e Auditit Ligjor, nje siguri te arsyeshme dhe te mjaftueshme, per rregullshmerine e veprimeve ekonomike, vertetesine e pronesise dhe vleres se kontributeve ne natyre, prone e aksionareve, per te cilat eshte marre edhe vendim nga asambleja e pergjithshme e aksionareve te kesaj shoqerie, per kalimin e tyre ne zmadhimin ne natyre te Kapitalit te Themeltar, te shoqerise shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane.

**Per te realizuar kete praktike kam konsideruar dhe proceduar, si vijon :**

**Baza Ligjore dhe dokumentacioni :**
Ligji Nr.9901, dt.14.04.2008 "Për Tregetaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar),
Ligjin Nr.10091,dt.05.03.2009"Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratura", (i ndryshuar) dhe SNA.
Ligjin Nr.9228, dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (i ndryshuar),
VKM me Nr.79, date 02.02.2011,
VKM me Nr.715, date 16.10.2012,
VKM me Nr.582, date 03.08.2016,
VKM me Nr. 728, date 08.12.2017,
Pasqyrat Financiare te datave 31 Dhjetor, te viteve 2016, 2017, 2018 dhe vijimi vitit 2019.
Certifikatat e pronesise mbi truallin (aktuale dhjetore 2019) e shoqerise QSKZ sh.a. , te cilat jane shoqerojne raportin e zmadhimit.
Vendimii, date 08 Maj 2019, te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tiranë : Per zmadhimin ne natyre te kapitalit themeltar te shoqerise.

K.Ndini

**Pergjegjesit ligjore ,**
Pergjegjesia per pergatitjen e bilanceve kontabel, dhe e vertetesise te dokumentave baze ligjor dhe kontabel eshte e drejtimit te shoqerise.

Pergjegjesia ime eshte, qe ne cilesine e Auditit Ligjor, te pergatis raportin ekspertimit kontabel per zmadhimin e kapitalit te themelimit nga kontributet ne natyre, me qellim dhenien e nje sigurie te arsyeshme dhe te mjaftueshme per rregullshmerine e praktikes se zmadhimin ne natyre te klapitalit themeltar, bazuar ne vendimin e dates 08 Maj 2019 te asamblese se pergjithshme te aksionareve.

**Baza e opinionit.**
**Opinioni im si Audit Ligjor,** lidhur me rregullmerine e kesaj praktike realizohet duke u bazuar ne Standartet nderkombetare te auditimit si dhe ne parimet, normat dhe rekomandimet profesionale te Auditeve Ligjor. Per kete qellim kam bere, verifikime te posacme dhe sondazhe, mbi elementet e kesaj praktike te kontributeve ne natyre per zmadhim kapitali, si dhe te deklarimeve financiare te raportuara nga shoqeria, duke perdorur metodat dhe teknikat profesionale me qellim arritjen e dhenies se nje sigurie te arsyeshme dhe te mjaftueshme, qe vlera e kontributeve ne natyre qe kalojne ne zmadhim te kapitalit te themelimit jane te rregullta dhe te sinqerta.

* * *

I. **Bazuar ne VKM me Nr.79, date 02.02.2011**, VKM me Nr.715, date 16.10.2012 dhe VKM me Nr.582, date 03.08.2016, asambleja e pergjithshme te aksionareve te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane, me vendimin e dates 08 Maj 2019 ka vendosur te behet zmadhimi i kapitalit themeltar i shoqerise nga kontributet ne natyre te pasurive te aksionareve, si me poshte :

| | |
|---|---|
| **1-Truall ..............................(36 300 m2 x 180 000 lek/m2)*...........** | **6 534 000 000 Lek.** |
| *2-Ndertesa ......................................................................................* | *526 477 756 Lek.* |
| *3-Makineri e pajisje.........................................................................* | *49 736 546 Lek.* |
| *4-Pajisje informatike .......................................................................* | *1 902 117 Lek.* |
| **Totali .........................................................................................** | **7 112 117 000 Lek.** |

*** Sqarim :**
**- Pika, 1-Truall , sipas certifikates aktuale te pronesise eshte 34 627 m2,** *dhe jo 36 300 m2.*
- **Siperfaqja 36 300 m2, eshte ne reference te VKM te sipercituara dhe te** raporti te ekspertizes se zvogelim KTH, te **shoqerise Qendra Sportive sh.a.** (Stadiumit Qemal Stafa), bazuar ne keto VKM.
- **Keto mosrakordime,** jane objekt i sistemimeve kontabile, qe duhet te beje drejtimi i shoqerise ne dijeni dhe miratim te APA te shoqerise "QSKZ" sh.a.

II. **Bazuar ne VKM me Nr. 728, date 08.12.2017,** asambleja e pergjithshme te aksionareve te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane, me Vendimin e dates 08 Maj 2019, ka vendosur te behet zmadhimi i kapitalit themeltar i shoqerise nga kontributet ne natyre te pasurive te aksionareve, si me poshte :

**5- Truall...............................( 2660 m2 x 66 969 Lek/m2)..............   178 137 540 Lek.**

**Pra, bazuar ne sa me siper,** sic edhe kam sqaruar, pasi kam verifikuar dokumentcionet baze ligjor dhe kontabel, pasqyrat financiare dhe vertetimet e pronesis te pasurive, per te cilat eshte vendosur nga APA e shoqerise "QSKZ"sh.a., te kontribuohen ne natyre per zmadhim te kapitalit te themelimit te shoqerise, **kam konstatuar se :**

K Naini

A. **Trojet (Aktive Afatgjata Materiale), objekt i kontributeve ne natyre per zmadhim te kapitalit themeltar te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane ;**

-Jane ne pronesi te Aksionareve.
-Ekzistojne fizikisht,
-Jane plotesisht ne funksion te objektit dhe qellimit te aktivitetit te shoqerise.

B. **Shoqeria ka zhvillim dhe vijimesi normale te aktivitetit ekonomik.**

**Certifikatat e pronesise (aktuale, Dhjetor 2019),** mbi trojet, te cilat jane objekt i zamdhimit te kapitalit themeltar, kane keto te dhena :

**Certifikata e Pronesise :**
Adresa ; Rr. "Bulevardi Barjam Curri", Tirane.
Zona Kad. 8160,
Nr.Pasurise 7/5,
Vol.17, fq.34,
Siperfaqa totale 34 627 m2
Nr.dok.00011270
Indeksi hartes TR-S-12
**Praktika e Certifikates Pronesise eshte e bashkelidhur me Raportin e Auditit Ligjor.**

**Vlera e Truallit eshte : Siperfaqe 34 627 m2 x 180 000 lek/m2 = 6 232 860 000 Lek.**
**Cmi dhe vlera**, ne reference te Nr.79, date 02.02.2011, VKM me Nr.715, date 16.10.2012 dhe ne praktiken e kalimit te pronesise nga shoqeria "Qndra Sportive"sh.a. (St Q.Stafa) ne shoqerine "QSKZ"sh.a.

**Bazuar ne VKM me Nr. 728**, date 08.12.2017, asambleja e pergjithshme te aksionareve te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane, APA me Vendimin e dates 08 Maj 2019, ka vendosur te beje zmadhimi i kapitalit themeltar i shoqerise nga kontributet ne natyre te pasurive te aksionareve, si me poshte :

**Certifikata e Pronesise :**
Adresa ; Rr. "Dervish Hima", Tirane.
Zona Kad. 8160,
Nr.Pasurise 7/55,
Vol.46, fq.100,
Siperfaqa totale 2 660 m2
Nr.dok.00016130
Indeksi hartes TR-S-12
**Praktika e Certifikates Pronesise eshte e bashkelidhur me Raportin e Auditit Ligjor.**

**Vlera e Truallit eshte : Siperfaqe 2660 m2 x 66 969 Lek/m2 = 178 137 540 Lek.**
**Cmimi/m2 i Truall,** eshte ne reference te VKM Nr.89, date 03.02.2016 "Miratimi i hartes se vleres se tokes ne RSH".

**Totali i vleres se trojeve qe kalojne ne zmadhim te kapitalit te shoqerise eshte 6 410 997 540 Lek.**

Nga verifikimet e pasqyrave financiare te shoqerine "QSKZ"sh.a., dhe te praktikes se kalimit te pasurive te tundeshme dhe te patuteshme, nga shoqeria "Qendra Sportive" sh.a. (Stadiumit Qemal Stafa), per ne shoqerine "QSKZ"sh.a., kam konstatuar se Aktivet Afatgjata Materiale te me poshtme aktualisht nuk mund te jene objekt i zmadhimit te kapitalit themeltar ;

K. Ndini

2-Ndertesa ........................................................................................ 526 477 756 Lek,
3-Makineri e pajisje.................................................................................. 49 736 546 Lek,
4-Pajisje informatike ............................................................................... 1 902 117 Lek,
**Vlrta totale ........................................................................................ 578 116 419 Lek,**

Pasi, keto AAM kane pesuar ndryshime dhe nuk ekzistojne fizikisht dhe funksionalisht. Faktet dhe ngjarjet ekonomike qe kane ndodhur lidhur me keto AAM, nga data e kalimit defakto te tyre ne pronesi te shoqerise "QSKZ"sh.a., deri ne daten e ketij raporti, jane te dokumentuara kronologjikisht nga qeverisja dhe jane objekt i miratimit nga vendim marrja e shoqerise.

Ne keto rrethana, bazuar ne gjithe sa me siper, konkludoj se zmadhimi i kapitalit te themelimit te shoqerise "QSKZ" sh.a., do te behet vetem per **vleren totale te trojeve ne shumen 6 410 997 540 Lek.**

**Duke konsideruar sa me siper, kapitalet e veta te shoqerise, para dhe pas zmadhimit te kapitalit themeltar ne natyre, paraqiten ;**

| III | KAPITALI | Pas zmadhimit 30 Nentor 2019 | Para zmadhimit 31.12.2018 |
|---|---|---|---|
| 1 | Aksionet e pakices ( PF te konsoliduara ) | | |
| 2 | Kapital i nenshkruar dhe i pa regjistruar | *756 254 540** | 7,290,254,540 |
| 3 | **Kapitali aksionar** | **6 412 997 540** | **2,000,000** |
| 4 | Prime te lidhura me kapitalin ( nga rivleresimi ) | | |
| 5 | Njesit ose aksionet e thesarit (negative) | | |
| 6 | Rezerva statutore | | |
| 7 | Rezerva ligjore | | |
| 9 | Fitimet e pashperndara( humbje te viteve te meparshem) | (786,808,892)** | (641,696,969) |
| 10 | Fitimi (Humbja) e vitit financiar | | (145,111,923) |
| | **Totali i kaptaleve te veta** | | **6,505,445,648** |

***Shenim :***
** Vlera 756 254 540 lek, ne postin "Kapital i paregjistruar...", eshte objekt i sistemimeve kontabile nga drejtimi dhe i vendimarrjeve te APA te shoqerise "QSKZ"sh.s.*
***Vlera 786,808,892 lek "Humbje te mbartura", eshte objekt i kualifikimit dhe destinimit aktual nga drejtimi i sdhoqerise dhe i vendimarrjeve te APA te shoqerise "QSKZ"sh.s.*

## Konkluzion :

**1- Zmadhimi i kapitalit themeltar sa dhe si me siper, eshte i rregullt dhe i bazuar ne dokumenta vertetues qe i aneksohen ketij Raporti .**

**2- Kapitali i themelimit,** para zmadhimit ishte 2 000 000 (dy milion) lek, dhe pas zmadhimit te kapitalit themaltar nga kontributet ne natyre edhe per shumen **6 410 997 540 lek, behet 6 412 997 540 lek** (Gjashtemiliard e katerqindedymbedhjetemilion e nentenentedhjeteshtate mije e peseqindedyzet) Lek.
**-Pra, Vlera totale kapitali themeltar pas zmadhimit eshte ...... 6 412 997 540 Lek.**

**3- Numri i aksioneve, nga 2 000 (dymije) aksione para zmadhimit, pas zmadhimit te kapitalit themeltar behet 6 412 997, 54** (Gjashtemiliard e katerqindedymbedhjetemilion e nentenentedhjeteshtate mije e peseqindedyzet) **aksione,.**

K Ndeu

**4- Vlera nominale nje aksioni ishte 1 000 (njemije) Lek/nje aksion dhe mbetet e pa ndryshuar ne vleren 1 000 (njemije) Lek/nje aksion.**

**5-** Nuk ka ndryshime ne perqindjet e zoterimeve te aksioneve te kapitalit aksionar te shoqerise "Qendra Sportive Kuq e Zi" sh.a., Tirane, pra, pas zmadhimit te kapitalit perqindjet e zoterimeve mbi aksionet e kapitalit themeltar, jane perkatesisht :

- **Federata Shqiptare e Futbollit, zoteron 75 % , te totalit te vleres se aksioneve, baras me nje vlere 4 809 748 155 Lek.**
- **Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrjes, zoteron 25%, te totalit te vleres se aksioneve, baras me nje vlere 1 603 249 385 Lek.**

Kristaq Ndini

KRISTAQ NDINI
Ekspert i Pavarur Ligjor
LICENSE NR 88
TIRANA ALBANIA

AUDITI LIGJOR

Tirane, me 05 Dhjetor 2019